



ANALIZË GJINORE / LEXIMI I PLATFORMAVE TË PARTIVE POLITIKE

Prizren - 2017

COPYRIGHT © 2017. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohet në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar të bëjë të qartë burimin e sigurimit të citateve apo materialeve të cilët shfrytëzohen.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,
10000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +381 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Web: www.kdi-kosova.org

Ky publikim është realizuar nga Instituti Demokratik i Kosovës në bashkëpunim me OJQ-në Ec Ma Ndryshe dhe iniciativën e grave dhe vajzave të Komunës së Prizrenit, FEMaktiv, ndërsa publikimi është bërë i mundur me përkrahjen e Olof Palme International Center. Opinonet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë analizë janë përgjegjësi e KDI-së, Ec Ma Ndryshe dhe FEMaktiv dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.

PËRMBAJTJA:

| | |
|---|---|
| Hyrja..... | 3 |
| Analiza e platformave të partive politike..... | 4 |
| Rekomandime..... | 7 |

HYRJA

Ky raport ka për qëllim ta bëjë analizën gjinore të platformave të partive politike në Prizren, të cilët garojnë për zgjedhje komunale të vitit 2017. Në këtë raport janë paraqitur mungesat sa i përket platformës së barazisë gjinore që përmbajnë partitë politike në programet e tyre zgjedhore. Në fund të analizës janë paraqitur rekomandimet për pushtetin lokal në Prizren, për hartimin e politikave në drejtim të krijimit të një qeverisjeje me perspektivë gjinore. Rekomandime këto për zgjidhje paraktive rreth çështjeve të rëndësishme sociale dhe ekonomike të grave dhe vajzave të Prizrenit.

Integrimi i perspektivës gjinore në politik-bërjen lokale mbetet një sfidë për qeverisjen komunale, sidomos kur është fjala për rrethanat e Kosovës. Ndërkaq, kjo sfidë është reflektuar edhe në platformat e partive politike të Prizrenit në zgjedhjet komunale të vitit 2017. Diskriminimi gjinor që bëhet ndaj grave dhe mendësia patriarkale, e cila është dominante edhe në diskursin politik dhe publik të qytetit, qëndron si problem thelbësor kundrejt së cilës duhet ndërmirren masa emergjente.

Hulumtimet tregojnë që gratë dhe vajzat në Komunën e Prizrenit përballen me probleme të shumta sociale dhe ekonomike. Ndër problemet kryesore të natyrës sociale dhe ekonomike janë: qasja në tregun e punës, qasja në kujdesin shëndetësor, siguria publike, arsimimi dhe aftësimi profesional. Shkalla e papunësisë së grave është e lartë në Kosovë, në veçanti për nënat vetushqyese, ku ato vazhdojnë të bien në kategorinë e grupeve të dobëta, pasi që kanë mundësi të vogla të punësimit, me qëllim të sigurimit të kushteve më të mira për fëmijët e tyre.¹ Situata e pafavorshme ekonomike, që vjen si rezultat i papunësisë - e në raste të rralla ku ka punësim - nga pagat e ulëta, është vetëm njëri nga faktorët e shumtë që kufizojnë mundësitë jetësore të grave dhe në veçanti nënave vetushqyese. Andaj, gratë vazhdojnë të përballen me shumë kushte të pafavorshme sociale dhe ekonomike.

Hulumtimet, po ashtu tregojnë se gratë, pothuajse gjithkund në botë kanë gjasa më të mëdha të jetojnë në varfëri për shkak të pjesëmarrjes së kufizuar në tregun e punës dhe të ardhurave të ulëta. Kjo për shkak

¹ "Strategjia e rishikuar për ri-integrimin e personave të riatdhesuar", Qeveria e Kosovës, 2010, Linku: <https://www.mpb-ks.org/repository/docs/Strategjia%20per%20Riintegrimin%20e%20personave%20te%20Riatdhesuar.pdf>, qasur më 17 tetor 2017

se gratë, me probabilitet të lartë, ose punojnë me orar të shkurtuar apo në vende pune që paguhen më pak, ngase ato ende konsiderohen si kujdestare kryesore të familjes. Raportin e Zhvillimit Njerëzor 2016, UNDP ka theksuar se Kosova ka shkallën më të ulët të punësimit të grave në rajon, me 12.5 për qind.²

Edhe pse gratë dhe vajzat në Komunën e Prizrenit përballen me çështje të rëndësishme të natyrës sociale dhe ekonomike, këto çështje nuk kanë qenë tema që janë trajtuar apo është ofruar ndonjë zgjedhje eventuale në platformat e partive politike. Çështja e barazisë gjinore është trajtuar në nivel simbolik në programet e partive politike, duke mos paraqitur asnjë strategji apo plan konkret se si do të arrihet barazia gjinore apo si do t'i zgjedhin problemet me të cilat përballen gratë dhe vajzat në Komunën e Prizrenit.

Gratë dhe vajzat në këtë Komunë përballen me shumë diskriminime gjinore, andaj edhe perspektiva gjinore si dhe zgjidhjet eventuale kundër diskriminimeve gjinore duhet të ishin disa nga politikat kryesore të partive politike, në këtë fushatë zgjedhore. Megjithatë, barazia gjinore më shumë është përdorur si një retorikë nga partitë politike ku edhe perspektiva gjinore kishe një rol shumë simbolik në platformat e tyre.

Gjatë fushatës zgjedhore 2017, përveç që nuk është diskutuar pothuajse aspak barazia gjinore dhe çështjet e rëndësishme sociale dhe ekonomike të grave dhe vajzave në Prizen, kishim vetëm një grua kandidatë për kryetare të Komunës. Përveç kësaj, fushata zgjedhore ka qenë tërësisht e dominuar nga burrat, fakt që ekspozon frymën ngulfatëse patriarkale dhe të diskriminimit gjinor.

Gratë dhe vajzat e Komunës së Prizrenit përballen me një numër të konsiderueshëm sfidash, ndërsa vështirësitë në adresimin e tyre lidhen kryesisht me faktin se këto probleme kanë marrë karakter strukturor. Aq më keq, kur të tilla probleme mundohen të normalizohen dhe të paraqiten si dukuri të natyrshme. Andaj, fushata zgjedhore 2017 ka qenë një ndër momentet shumë të rëndësishme për t'i ngritur këto debate dhe për të gjetur zgjedhje eventuale për këto sfida.

Ndonëse janë ndërmarrë shumë iniciativa drejt arritjes së barazisë gjinore dhe përmirësimit të gjendjes sociale dhe ekonomike të grave dhe vajzave në Prizren, ato nuk janë përkthyer në politika konkrete të partive politike në fushatën zgjedhore 2017.

² "Tregu i punës në funksion të grave dhe të rinjve" – Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë 2016, UNDP, linku www.ks.undp.org/content/.../kosovo/.../UNDP_HDR_ALB_web.pdf, qasur me 18 tetor 2017

ANALIZA E PROGRAMEVE TË PARTIVE POLITIKE NË PRIZREN

Deri më tani kemi parë që Komuna e Prizrenit përpos objektivit të deklaruar në planin e veprimit për barazi gjinore për fuqizimin ekonomik dhe rritjen e punësimit të grave, nuk ka arritur që të zbatojë politika konkrete në realizimin e këtij objekti. Ndërsa sfidat e përfshirjes së perspektivës gjinore në politika konkrete është reflektuar edhe në platformat e partive politike.

Kyqja e grave në tregun e punës qëndron si një ndër problemet kryesore të natyrës sociale ekonomike që përballen gratë dhe vajzat në Komunën e Prizrenit. Ndërkaq, në platformat e partive politike nuk janë përfshirë fare apo janë përfshirë në nivele shumë të ulëta zgjidhjet eventuale rreth problemeve sociale dhe ekonomike me të cilat përballen gratë dhe vajzat në Prizren.

Gratë kanë pjesëmarrje shumë të ultë në tregun e punës, ku ndër shkaqet e kësaj gjendjeje është edhe fakti se kujdesin për fëmijë e ka përsipër vetëm gruaja. Mungesa e çerdheve publike në Prizren e thellon këtë padrejtësi për gratë. Në platformën politike të Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) është paraparë ndërtimi i katër çerdheve publike me kosto të përballueshme në Prizren. Kjo do të mundëson që gratë të kenë më shumë kohë, edhe kursim nga pagat e tyre. Ndërkaq, edhe pse kjo politikë mundëson që gratë të kenë më shumë kohë që të kyçen në tregun e punës, nuk e zhdok apo lufton drejtpërdrejtë rolin tradicional të grave – ku përkujdesi ndaj fëmijëve shihet si obligim që i takon vetëm grave.

LVV ka paraparë të bëjë riorganizimin dhe funksionalizimin e Qendrave Kryesore të Mjekësisë Familjare, paisja me mjete, laboratorë funksionalë dhe trajnim i personelit mjekësor. Mirëpo, kjo politikë nuk është e specifikuar për gra, edhe pse ato përballen me shumë probleme për t'u qasur në qendrat e kujdesit shëndetësor, sidomos ato të cilat janë në gjendje të vështirë ekonomike.

Në platformën politike të Lidhjes Dekomratike të Kosovës (LDK) është cekur se për zhvillimin ekonomik të Komunës së Prizrenit do të krijohet një Qendër për fitimin e përvojave praktike për punësim dhe vetëpunësim, në profile të caktuara, ku është cekur që do të jetë në veçanti për gra. Ndërkaq, LDK në

|||||

platformën e tyre politike nuk paraqet ndonjë politikë tjetër apo strategji konkrete drejt përmirësimit të gjendjes sociale dhe ekonomike të grave dhe vajzave në Komunën e Prizrenit. Perspektiva gjinore në platformën e LDK-së duket që ka më shumë një rol simbolik.

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në programin e tyre politik është zotuar që për zbatimin e papunësisë në Komunën e Prizrenit do të krijojë Fondin për Zhvillimin e Qytetit prej 2 milionë eurosh, për t'i përkrahur bizneset e reja që do të hapen nga të rinjtë dhe gratë. Idetë më të mira dhe kreative do të mbështeten financiaisht. Megjithatë, Fondi për Zhvillimin e Qytetit, i cili synon zbatimin e papunësisë në Komunën e Prizrenit, nuk paraqitet si një politikë e veçantë për përmirësimin e gjendjes sociale dhe ekonomike të grave në Komunën e Prizrenit.

Në anën tjetër, në platformën politike të PDK-së është cekur që gratë lehona të Komunës së Prizrenit do të përkrahen me një shumë deri në 300 euro në vit. PDK në bashkëpunim me Universitetin e Prizrenit, synon që për çdo vit do të organizojë "Panairin e Punës" ku të rinjtë dhe gratë do të mund të takohen drejtëpërdrejt me bizneset.

Në platformën politike të Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) është paraqitur që do të ketë përkujdesje të vazhdueshme për nënat/gratë vetëushqyese (gratë të cilat mbajnë familje). Megjithatë, në platformën e tyre politike nuk është cekur asnjë politikë konkrete se çfarë përkrahje do të bëhet për nënat vetushqyese, në mënyrë që ato dhe fëmijët e tyre të kenë një jetë më të dinjitetshme. Ndërsa politikat tjera të cilat janë cekur në platformën e tyre janë pa perspektivë gjinore.

Aleanca Kosova e Re (AKR) e cila garon në zgjedhjet Komunale në Prizren nuk ka platformë politike, ndërsa në ueb faqen e tyre, AKR ka paraqitur disa prioritetet për qeverisjen lokale në Prizren, ku brenda tyre nuk ka asnjë pikë që synon arritjen e barazisë gjinore apo ndonjë zgjidhje eventuale rreth përmirësimit të gjendjes sociale dhe ekonomike të grave edhe vajzave të Prizrenit.

Në platformën politike të Nismës nuk është aspak e integruar perspektiva gjinore. Nisma në programin e saj ka paraqitur që do të ketë zhvillim të politikave mbështetëse për gratë fermere, ndërsa nuk është cekur se cilat janë politikat konkrete me të cilat do të mbështeten gratë fermere. Përveç kësaj nuk ka asnjë politikë tjetër që garanton barazi gjinore apo përmirësim të gjendjes sociale dhe ekonomike të grave në Prizrenit.

Në platformën politike të Alternativës barazia gjinore është në theks të veçantë. Alternativa, me anë të

|||||

përkrahjes së bizneseve të themeluara dhe drejtuara nga gratë, synon të përmirësojë gjendjen sociale dhe ekonomike të grave në Komunën e Prizrenit. Për të përkrahur bizneset e themeluara nga gratë, sipas tyre, ekzistojnë disa mekanizma që do të futen në funksion: përkahje financiare për gratë të cilat fillojnë dhe zgjerojnë biznesin e tyre; përjashtim nga detyrimet komunale për biznes me pronësi nga gratë; ofrim i tokës dhe pronës në shtytëzim apo me qera; hapja e zyreve për këshillëdhënie; përmirësimi i praktikave të punësimit në nivelin lokal (eliminimi gradual i praktikave diskriminuese në punësim dhe ngritja e transparencës në rekrutim).

Analiza gjinore e platformave të partive politike tregon se diskriminimet gjinore që bëhen ndaj grave si në jetën politike dhe publike, poashtu në atë sociale dhe ekonomike nuk janë marrë seriozisht nga partitë politike. Problemet e shumta të pabarazisë gjinore, vazhdojnë të neglizhohen dhe të mos merren seriozisht nga subjektet politike. Për më tepër, duket se platformat e partive politike, çështjen e barazisë gjinore e kanë paraqitur në një pikë për të mos thënë që nuk e kanë cekur fare. Pikat të cilat janë të paraqitura në platformat e partive politike, të cilat garojnë në zgjedhjet lokale për Komunë të Prizrenit, janë të pakta, e në disa raste mungojnë fare. Në platformat politike, në të cilat politikat gjinore janë të cekura minimalisht, ato kanë më tepër elemente sipërfaqësore, meqë nuk parashohin, zhdukje apo zbutje të problemeve. Pra, politikat gjinore, në platformat elektorale, përveç që janë shumë pak të prekura, janë edhe të përmendura sipërfaqësisht.

REKOMANDIME

- Respektim i ligjit për barazi gjinore në ekzekutiv: pjesëmarrje të barabartë të burrave dhe grave; përfaqësim të barabartë në institucione.
- Duhet të ketë siguri të shtuar në hapësira publike që paraqesin pasiguri për gratë dhe vajzat; me theks të veçantë janë hapësirat ku ka mungesë të ndriçimit publik, në mënyrë që të eliminohen ngacmimet seksuale në rrugë.
- Duhet të intensifikohen politikat dhe programet për arritjen e barazisë gjinore, sidomos për përfshirjen e grave në tregun e punës, me ç'rast një kujdes i veçantë duhet të ofrohet për përkrahjen e punësimit të nënave vetushqyese.
- Të ndërmerren masa konkrete për adresimin e problemeve të çështjes së banimit për nënat vetushqyese;
- Komuna të bashkëpunojë me partner nga niveli qendror, dhe të organizojë fushata për promovimin e ndërmarrësisë së grave,
- Duhet të ketë subvencione edhe/ose të bashkëfinancohen iniciativat biznesore të udhëhequra në pronësi të grave.
- Duhet të iniciohet rishikimi i politikës së taksave komunale për biznese në pronësi të grave.
- Ofrim i shfytëzimit të pronës së Komunes për gratë në biznes.
- Duhet të krijohen politikat që mundësojnë qasje fizike në qendrat e kujdesit shëndetësor të nivelit primar, sidomos për gratë në gjendje të vështirë ekonomike.
- Të ndërmerren masat për hapjen e shkollave profesionale në mënyrë që gratë të aftësohen në profesione që kërkon tregu.

This publication is part of the project "United women for a gender friendly political, economic and social governance", implemented by (KDI, Ec ma Ndryshe and FEMaktiv, financed by Olof Palme International Center supported by Swedish Government. Content of this publication reflects author's opinions and not necessarily Olof Palme International Center opinions.

